



**BASHKIA**  
**REPUBLIKANË SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 132, datë 30.09.2020**

**“PËR**  
**DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE ME**  
**LOGON “NSZZ SOLIDARNOŚĆ” NGA AMBASADA POLAKE, ME QËLLIM**  
**PASURIMIN E MEMORIALIT “POSTBLOK”, I CILI PËRKUJTON VIKTIMAT E**  
**REGJIMIT KOMUNIST NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 650, datë 31.07.2013, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë të Qarkut Tiranë”, shkresën me nr. 3265 prot., datë 22.01.2020, të Ambasadës së Polonisë drejtuar Bashkisë Tiranë, Memo-s me nr. 3265/2 prot., datë 15.05.2020, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

- 1.** Të japë pëlqimin për vendosjen e pllakës përkujtimore, me logon “NSZZ SOLIDARNOŚĆ” nga Ambasada Polake, në krah të selisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në memorialin “PostBlok”, në nderim të viktimave të regjimit komunist në Shqipëri, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.** Vendosja e pllakës përkujtimore në vendin e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, shoqërohet me të gjithë dokumentacionin urbanistik të kërkuar.
- 3.** Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**